Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Seminar Informues për Tregun e Lirë të Energjisë Elektrike

Zyra e Rregullatorit për Energji
10 Qershor 2025
Hotel Venus - Prishtinë

Liberalizimi i Tregut dhe Baza Ligjore

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike mbështetet në Ligjin Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe aktet nënligjore të miratuara nga ZRRE. Ky proces është në përputhje të plotë me direktivat e Evropiane dhe synon krijimin e një tregu konkurrues dhe transparent.

Qëllimi kryesor i liberalizimit është t'u mundësojë konsumatorëve të zgjedhin vetë furnizuesin e tyre, duke promovuar kështu konkurrencën dhe përmirësimin e shërbimeve në sektorin e energjisë elektrike.



Ligji Nr. 05/L-085 Lligji që Energji Elektrike

Baza kryesore ligjore

Aktet Nënligjore

Rregulla që FMF, Rreg. për ndrrimin e Furnizuesit

Obligimi për dalje në treg të lirë

01 qershor 2025

Tregu i Lirë?

Konkurrencë e Hapur

Tregu i lirë i energjisë elektrike funksionon sipas parimit të konkurrencës së hapur, duke lejuar furnizuesit të konkurrojnë për konsumatorët.

Ndërrim i Furnizuesit

Konsumatorët mund të ndërrojnë furnizuesin sipas nevojës, gjithmonë në përputhje me kontratat ekzistuese.

Çmim i Parregulluar nga ZRRE

Çmimi i energjisë nuk është më i rregulluar nga ZRRE, por përcaktohet në marrëveshje ndërmjet konsumatorit dhe furnizuesit.

Negocim i Drejtpërdrejtë

Konsumatorët kanë mundësinë të negocioni drejtpërdrejt çmimin dhe kushtet e furnizimit me energji elektrike.

Procedurat për Lidhjen e Kontratës me Furnizuesin

Posedoni profiling e ngarkesës

Profili i ngarkesës është kushti I pare për ta kërkuar ofertën tuaj.

Kërkoni Ofertë dhe Krahasoni Ofertat

Kërkoni ofertë nga një ose më shumë furnizues të licencuar dhe krahasoni ofertat sipas çmimit, kushteve dhe shërbimeve shtesë për të gjetur alternativën më të përshtatshme.

Nënshkruani Kontratën

Nënshkruani kontratën me furnizuesin e përzgjedhur pas vlerësimit të kushteve më të favorshme.

Njoftimi i Operatorit

Furnizuesi e njofton Operatorin e Sistemit për ndryshimin dhe kalimi bëhet tek furnizuesi i ri.

Roli i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)

Mungesa e Kontratës

Nëse për ndonjë arsye nuk arrini të lidhni kontratë me një furnizues, aktivizohet mekanizmi i FMF-së.

Furnizim i Përkohshëm

Do të furnizoheni përkohësisht nga KEK, që është caktuar nga ZRRE si furnizuesi i mundësisë së fundit.

Periudhë e Kufizuar

Ky shërbim ofrohet për deri në 60 ditë.

Gjetja e Furnizuesit të Ri

Gjatë kësaj kohe, ju duhet të gjeni një furnizues të ri dhe të nënshkruani kontratë të rregullt.

Ju inkurajojmë të mos prisni momentin e fundit për këtë proces, por të filloni sa më shpejt për të siguruar kushte optimale.

Procedurat e Ndërrimit të Furnizimit

Dalje Automatike

Dalja aktuale është dalje automatike, e cila nënkupton se të gjithë konsumatorët e kualifikuar, që nuk kan gjetur furnizues, me automatizim e gëzojnë të drejtën e furnizimit të garantuar.

Fleksibilitet në Ndërrim

Konsumatorët mund ta ndërrojnë furnizuesin e tyre kurdo që ata e shohin të arsyeshme sipas strategjive të tyre.

Proces i Thjeshtë

Procesi i ndërrimit të furnizuesit është dizajnuar të jetë i thjeshtë dhe transparent, duke shmangur ndërprerjet në furnizim.

Ndërrimi i furnizuesit është një e drejtë themelore në tregun e liberalizuar dhe procedurat janë hartuar për të lehtësuar këtë proces për të gjithë konsumatorët e kualifikuar.

Rekomandime Praktike për Bizneset

Analizoni Profilin e Konsumit

Analizoni modelet tuaja të konsumit të energjisë. Konsiderojeni mundësinë e bashkimit të portofolios suaj me konsumatr tjerë.

Kërkoni Oferta të Shumta

Kërkoni disa oferta nga furnizues të ndryshëm për të krahasuar kushtet dhe për të gjetur alternativën më të përshtatshme.

Mos u mbështeteni në FMF

Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është vetëm zgjidhje e përkohshme dhe zakonisht me çmime më të larta.

Siguroni Kontratë të Qartë

Sigurohuni që kontrata të jetë e qartë dhe e përshtatshme për nevojat tuaja specifike të biznesit.

Faleminderit !

Zyra e Rregulaltorit për Energji

Adresa: Rr.. Bekim Fehmiu, kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë

www.ero-ks.org